



Republika e Kosovës
Komuna e Drenas(Gllogoc)
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 170101-62244 dt. 28/12/2023

Bazuar në nenin 11,12 paragrafi 40 Ligjit për Vetëqeverisje lokale Nr.03/I-040, si dhe bazuar në nenin 3, pika 3.5 dhe nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë, **27.12.2023**, miratoi këtë:

VENDIM

Për shpalljen e z. Jakup Krasniqi, "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit

Neni 1

Ky Vendim miratohet nga Kuvendi i Komunës për shpalljen e z. Jakup Krasniqi "Qytetar Nderi" i Komunës së Drenasit.

Neni 2

Titulli "Qytetar Nderi" për z. Jakup Krasniqi i jepet për kontributin e tij në luftën çlirimtare, shtet formim e shtet ndërtim dhe proceset historike që ka kaluar Kosova.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i komunës së Drenasit.

Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi i dërgohet:
Zyrës së Kryetarit ;
Drejtorisë Përkatëse;
Zyrës së Kuvendit;
Arkivit;
Palës;



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari

ARSYETIM

Jakup Krasniqi i lindur me 1 janar 1951 ne fshatin Negrovç të Komunës se Drenasit, qysh beret kishte nisur aktivitetin ilegal për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Pasi kishte mbaruar shkollën fillore në vendlindje dhe të mesmen në Drenas, Krasniqi, studimet i mbaroi ne Prishtinë, në Fakultetin Filozofik, dega Histori.

Me pas kthehet ne vendlindje dhe nga viti 1972 deri ne vitin 1977 punon si arsimtar në Negrovç dhe Arllat, ndërsa, në vitet 1976-1977 punon edhe si arsimtar në Shkollën e Mesme në Drenas. Po ashtu Krasniqi kishte punuar në vitet 1979-1981 Arsimtar në Arllat dhe pastaj në Shkollën e Mesme në Skenderaj, kurse me 1991-1994 Arsimtar ne gjimnazin "Skenderbeu" në Drenas.

Gjate kohës sa punonte si mësues, Krasniqi ishte marrë edhe me aktivitete politike ne ilegalitet. Për këto aktivitete, Krasniqi në vitin 1981 ishte burgosur nga pushteti i atëhershëm serb, ku kishte qëndruar deri ne vitin 1991.

Krasniqi gjatë vitit 1995-1998 ka qenë edhe kryetar i Këshillit të Arsimit në Drenas. Ndërsa, ka qenë edhe anëtar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, deri ne luftën e fundit. Krasniqi kishte rol të rëndësishëm në krijimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Gjatë luftës, ai ishte anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, ku me pas ishte emëruar zëdhënës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës gjatë viteve 1998-1999.

Si anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, Krasniqi ishte pjesë e delegacionit të Kosovës në konferencën e Rambujesë, në Francë, e cila i dha fund luftës me bombardimin e Serbisë nga NATO për 78 dite me radhë, nga 24 marsi deri me 12 qershor kur kishin hyrë në Kosovë forcat paqeruajtëse. Me përfundimin e luftës, Krasniqi ishte bashkuar me bashkëluftëtarët për të themeluar Partinë Demokratike të Kosovës, pjesë e së cilës ishte deri ne vitin 2014.

Ne vitin 2001, ne zgjedhjet e para parlamentare të pasluftës, Krasniqi ishte zgjedhur deputet i legjislaturës së pare. Ndërsa, pas formimit të Qeverisë së pare, të udhëhequr nga Bajram Rexhepi, Krasniqi ishte bërë Ministër i Shërbimeve Publike.

Deputet ishte zgjedhur serish ne vitin 2004, ne zgjedhjet parlamentare qe ishin zhvilluar atë kohe, ku ishte emëruar shef i grupit parlamentar të PDK-së.

Me ardhjen e PDK-së në pushtet në vitin 2008, pas zgjedhjeve që ishin mbajtur në nëntor të vitit 2007, Krasniqi ishte zgjedhur në krye të Kuvendit të Kosovës.

Krasniqi ishte zgjedhur serish në krye të Kuvendit në vitin 2010 pas zgjedhjeve parlamentare.

Në vitin 2014, pas disa përplasjeve me bashke partiakët, Krasniqi i ndan rrugët me PDK-në, duke formuar Nismës për Kosovën, bashke me Fatmir Limaj dhe disa aktivist të kësaj partie.

Krasniqi zgjidhet kryetar i Këshillit Kombëtar të Nismës për Kosovën, e cila me vone ndërron emrin dhe bëhet Nisma Socialdemokrate e Kosovës.

Kjo biografi e dëshmon se motivi për ta shpallur "Qytetar Nderi" të Komunës së Drenasit është meritë.